

Në këtë rast Struktura e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore informon me shkrim Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore duke e vënë në dijeni për rrethanat e reja.

4.3. Struktura e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore ka të drejtë të gjykojë dhe të anulojë gjopa, plotësisht apo pjesërisht, pavarësisht nga vlefshmëria e detyrimit tatimor, në rastet e parashikuara në përputhje me nenin 111 të Ligjit "Për procedurat tatimore". Ky gjykim bazohet në analizimin e plotë të arsyeve dhe rrethanave në të cilat është kryer shkelja, duke evidentuar faktet dhe argumentet e mbi bazën e të cilave bëhet gjykimi dhe merret vendimi.

4.4. Vendimi i Strukturës Vendore të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të përfshijë një shpjegim me shkrim të mënyrës së arsyetimit siç parashikohet në nenin 100 të Ligjit të Procedurave Administrative. Ai nënshkruhet nga Drejtori i Drejtorisë së Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore apo nga Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit të Apelit të Taksave dhe Tarifave vendore.

a) Arsyetimi duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsyetimi është bërë mbi bazën e informacioneve 21 apo propozimeve të mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimit i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar. Në këto raste informacionet dhe propozimet janë pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar;

b) Vendimi duhet të përfshijë një dispozitë që vë në dijeni taksapaguesin për të drejtën e tij për ankimin e vendimit në gjykatë dhe i dërgohet taksapaguesit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi.

c) Përdorimi për arsyetim i të dhënave të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barsvlershëm me mungesën e arsyetimit. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme.

4.5. Pas shqyrtimit të çështjes, Struktura Vendore e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, vendos:

i. Të refuzojë ankimin për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm;

ii. Ta rrëzojë ankimin;

iii. Ta anulojë aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose

iv. Ta pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe ta ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.

Struktura e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të rrëzojë një ankim në qoftë se:

a. gjykon që ankimimi është i pabazuar pasi procedura është ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka qenë i drejtë dhe ligjërisht korrekt, ndërsa ankimimi është i pabazuar;

b. zbulon që ka pasur mosveprime (ose gabime të administratës tatimore), por që ato kanë qenë aq të parëndësishme sa që nuk mund ta kenë ndikuar në vendimin administrativ;

c. akti administrativ është bazuar në ligj, por për arsye të tjera nga ato të shprehura në akt, ajo shpjegon këto arsye në vendim.

Struktura Vendore e Apelit plotëson procedurën dhe eliminon mungesat vetë ose mund t'ia kërkojë këtë gjë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në qoftë se:

a. Konstaton që faktet në procedurë janë përcaktuar me mungesa dhe gabime;

b. Konstaton që procedura nuk ka mbajtur parasysh rregullat procedurale që mund të kenë ndikuar aktin administrativ; ose,

c. Konstaton që përmbajtja e aktit administrativ të kundërshtuar është e paqartë ose bje ndesh me shpjegimet e tij.



Struktura Vendore e Apelimit në bazë të fakteve të vërtetuara gjatë procedurës, vendos anulimin e aktit administrativ dhe vendos vetë për çështjen ose i kërkon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ta zgjidhë atë nëse konstaton që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore:

- I ka vlerësuar provat gabimisht;
- Ka nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet e parashtruara;
- Ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi është zbatuar gabimisht; ose,
- Struktura Vendore e Apelimit është e mendimit që duhej marrë një vendim i ndryshëm nga ai i marrë.

Ankimuesi mund të heqë dorë nga ankimi para nxjerrjes së vendimit të ankimit. Në këtë rast, procedura e ankimit ndërpritet me një vendim për mbylljen e procedurës së ankimit.

5. AFATI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT NGA STRUKTURA VENDORE E APELIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT KUNDËR VENDIMIT TË KËSAJ STRUKTURE NGA TAKSAPAGUESI

5.1. Afati i shqyrtimit të ankimit nga Struktura Vendore e Apelimit

Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore vendos brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së ankimit. Në qoftë se dita e fundit e këtij afati bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

Në qoftë se ankimi nuk përmbush kriteret formale sipas pikës 3, afati 60-ditor fillon një ditë pas plotësimit të kërkesave formale nga ankimuesi por jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas marrjes së ankimit. Në asnjë rast koha e shqyrtimit të ankimit nga Struktura Vendore e Apelimit nuk mund të kalojë 90 ditë duke filluar nga data e marrjes së ankimit.

Në qoftë se Struktura Vendore e Apelimit nuk nxjerr vendim brenda 60 ditësh nga marrja e ankimit të plotësuar si duhet, taksapaguesi MUND TË FILLOJË një ankim gjyqësor edhe në mungesë të vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në qoftë se vendimi i ankimit varet plotësisht ose pjesërisht nga një çështje e mëparshme që është subjekt i procedurave gjyqësore ose është nën juridiksionin e një organi tjetër publik, Struktura Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çështjes së mëparshme.

Gjithashtu, në rastin e pezullimit të një procedure, vendimi përfundimtar i Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të nxirret brenda gjashte muajsh nga data e marrjes së ankimit të plotësuar si duhet.

Përndryshe ankimuesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë.

5.2. E drejta e ankimit kundër vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit

Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë ankimim në rrugë gjyqësore kundër vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi. Megjithatë, në qoftë se taksapaguesi nuk është njoftuar korrektësisht ose nuk ka marrë dijeni për të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e Strukturës Vendore të Apelimit, ankimi në gjykatë bëhet brenda tre muajsh nga data kur vendimi është marrë.

Mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore në mungesë të një vendimi të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore vetëm në qoftë se:



- a. Akti administrativ nuk përfshihet në objektin e apelimit sipas pikës 2 të këtij Udhërrëfyesi; ose,
- b. Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk nxjerr vendim brenda 60 ditësh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet, ose në rast pezullimi, nuk nxjerr vendim brenda gjashtë muajsh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet.
- Për një akt administrativ objekt ankimi, NUK mund të kapërcehet faza e ankimit administrativ dhe të bëhet ankim drejtpërsëdrejti në gjykatë.

6. RIMBURSIMI I DETYRIMIT TATIMOR VENDOR, KAMATËVONESËS DHE/OSE GJOBËS NE RASTET E PARAPAGIMIT NË PROCESIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV

- 6.1. Nëse vendimi i Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore është në favor të taksapaguesit, detyrimi i parapaguar nga taksapaguesi, i rimbursohen taksapaguesi brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit .
- 6.2. Nëse taksapaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit
- 6.3. Nëse Struktura Vendore e Apelimit lë në fuqi vendimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe taksapaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin taksën apo tarifën, në rastin kur nuk është paguar, ose është vendosur garanci, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga taksapaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit .

7. EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË STRUKTURËS SË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE APELIMI NË GJYKATË

- 7.1 Vendimi i Strukturës Vendore të Apelimit ekzekutohet pas njoftimit të këtij vendimi.
- 7.2 Nëse nuk është dakord, me vendimin e Strukturës Vendore të Apelimit, taksapaguesi mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.
- Nëse Struktura Vendore e Apelimit nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatë.**

KRYETAR

Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 45, date 16/06/2018

“PER MIRATIMIN E TRASFERIM FONDESH DHE NDRYSHIME NE BUXHETIN E BASHKISE PER
VITIN 2018”

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore“, Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per nenaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH”, te ligjit nr.109/2017 date 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“, Udhezimi nr.2 date 6.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, i ndryshuar, te VKB nr.76 date 22.12.2017 “Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2018, vendimit nr.7 date 11.05.2018 te Komitetit te Zhvillimit te tajeve, Keshilli i Bashkise;

V E N D O S I:

Miratimin e fondit per bashkefinansim nga B.Roskovec per objektet e investimeve per dy projektete e reja , grante “Arsimi” me cikel zbatimi 2018-2019 nga FZHR si me poshte:

1. “Rikonstrukcion I shkolles 9-vjecare “Ajet Toska”, Suk 2” , vlera e plote e projektit 49,545,463 leke , vlera e financimit i B.Roskovec 4,954,546 leke, nga e cila **2,477,273 leke per vitin 2018** dhe 2,477,273 leke per vitin 2019 .
2. “Ndertim ambjentesh sportive+palester shkolla “Alush Grepcka”” , vlera e plote e projektit 57,369,135 leke , vlera e financimit i B.Roskovec 5,738,914 leke , nga e cila **2,869,457 leke per vitin 2018** dhe cila 2,869,457 leke per vitin 2019 .

Fondi prej **5,346,730 leke** , financim I bashkise per dy objektete e mesiperme per vitin 2018, nga teprica e fondeve te ngelur pas fillimit te procedurave te prokurimeve te planifikuar ne buxhetin e vitit 2018:

Shtohet:	Gr.00 Tit.09120 Kap.01 Art.231	1,365,000 leke
	Gr.00 Tit.09120 Kap.05 Art.231	3,981,730 leke




Pakesohet: - Gr.00 Tit.06630 Kap.05 Art.231	3,981,730	leke
- Gr.00 Tit.08250 Kap.01 Art.231	1,365,000	leke

- II. Te miratoje numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë nga 313 që është aktualisht në 321 , pra 8 punonjes shtese (2 punonjes ndihmes për qendren rinore dhe 6 punonjes për mirembajtje rrugë e tortuare).
- Fondi të përballohet nga fondi I planifikuar për programet përkatëse në buxhetin e bashkisë për vitin 2018.

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 46.DATË 16.06.2018

“PËR

QERADHËNIEN E ZYRAVE PËRKATËSE TË BASHKISË ROSKOVEC”

Në mbështetje të Kodit Civil nenet 801-825 ; të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 , pika 1.2 , gërma a, neni 54 , gërma e ; te Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017) ; të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” ; si dhe të dy kërkesave të depozituara në zyrën e protokollit të Bashkisë Roskovec;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin për dhënien me qera të ambienteve të mëposhtme përkatësisht për të dy kërkuessit:

1) **Organizata Jofitimprurëse me seli në Roskovec** : “*Gruaja , komuniteti, mjedisi harmonizuar për zhvillim*”- zyrë me sipërfaqe 6 m2 , në godinën e Qendres Rinore Roskovec, pronë e Bashkisë Roskovec.

2) **Dega e Partisë Socialiste Roskovec** : zyrë 36 m2 në godinën e Pallatit të Kulturës Roskovec , pronë e Bashkisë Roskovec.

2.Afati i qeradhënies për të dyja pronat , do të jetë 1 (një) vit me të drejtë përsëritjeje, pas miratimit të qeradhënësit.

3.Çmimi për qeramarrjen (*sipas studimit të tregut*) do të jetë 5000 (*pesëmijë*) lekë në muaj.

Bashkëngjitur planvendosjet për të dyja pronat.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

NR 47, DATE 16.06.2018

“PER MIRATIMIN E PRIORITETEVE PER INVESTIME PER VITIN 2018”

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH”, te ligjit nr.109/2017 date 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore”, te ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, si dhe projekt-preventivave perkatese; Keshilli i Bashkise;

V E N D O S I:

Miratimin e prioriteteve per investime per vitin 2018 per objektet e meposhtme:

1. ”Ndertimi i rrjetit te ujesjellësit , lagja “Fushe” , fshati Kurjan”
2. ”Ndertimi i rrjetit te ujesjellësit , lagja “Ish-kompleksi blektoral” , Roskovec”
3. ”Ndertimi i rrjetit te ujesjellësit , fshati Strum”
4. ”Ndertimi i rrjetit te ujesjellësit, lagja “Misirit”,fshati Mbers”
5. “Rehabilitimi Urban i bllokut nr.2 Roskovec”
6. “Rikualifikimi Urban dhe pyllezim i liqenit te Kurjanit”
7. Ndertim i Parkut Agroturistik dhe rehabilitimi i rruges hyrese, fshati Luar”

KRYETAR

Eleni GOGA

